GJYKATA EUROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 56080/19
2001 sh.p.k.
kundër Shqipërisë

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 30 maj 2023, si Komision, i përbërë nga:

Georgios A. Serghides, *kryetar,*

Darian Pavli,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendësregjistrare e Seksionit,*

Duke pasur parasysh,

kërkesën (nr. 56080/19) ndaj Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës në mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa"), më 18 tetor 2019, nga një kompani shqiptare, "2001" sh.p.k, themeluar në vitin 2006 dhe me seli në Lezhë ("kompania kërkuese"), e cila u përfaqësua nga z. P. Ndreca, avokat i cili ushtron ligjin në Tiranë;

vendimin për të vënë në dijeni në lidhje me kërkesën Qeverinë Shqiptare ("Qeveria"), e cila u përfaqësua nga Agjenti i saj në atë periudhë, znj. B. Lilo dhe më pas z. O. Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit;

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

LËNDA E ÇËSHTJES

1. Kërkesa ka të bëjë me drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe kohëzgjatjen e procesit civil, si edhe aspektin e shterimit të mjeteve vendase, më konkretisht duke paraqitur ankesa përpara Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, në kontekstin ku ato gjykata nuk kishin mjaftueshëm gjyqtarë në staf për një periudhë të caktuar kohore.

A.Procesi vendas

2. Më 2 prill 2009, kompania kërkuese depozitoi një padi për dëmshpërblim në shumën prej 169,895,010 lekë (rreth 1,300,000 euro në periudhën konkrete) ndaj një pale private pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.

3. Në një datë të papërcaktuar në vitin 2012, kompania kërkuese iu referua situatës së saj të vështirë financiare për t'i kërkuar gjykatës që të përjashtohej nga detyrimi për të paguar tarifën gjyqësore, e cila, sipas ligjit vendas, përbënte një për qind të shumës së kërkuar. Gjykata e kundërshtoi kërkesën dhe i kërkoi kompanisë kërkuese që të paguante tarifën gjyqësore përkatëse.

4. Më 16 maj 2013, Gjykata e Rrethit Tiranë konstatoi se kompania kërkuese nuk e kishte paguar tarifën gjyqësore dhe ndërpreu shqyrtimin e padisë. Kompania kërkuese e apeloi vendimin, duke argumentuar se i përmbushte kushtet për t'u përjashtuar nga detyrimi për të paguar tarifën gjyqësore dhe se e drejta e saj për t'iu drejtuar një gjykate nuk mund të ndikohej nga një legjislacion dytësor që parashikonte detyrimin për shlyerjen e tarifës gjyqësore.

5. Më 20 nëntor 2013, Gjykata e Apelit Tiranë la në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Ajo gjykoi se detyrimi për të paguar tarifën gjyqësore parashikohej nga ligji dhe ndërprerja e procesit nga gjykata e shkallës së parë ishte i justifikuar. Më 25 nëntor 2013, kompania kërkuese depozitoi një rekurs në Gjykatën e Lartë.

6. Më 18 tetor 2019, kompania kërkuese depozitoi pranë Gjykatës kërkesën konkrete, që më pas iu komunikua Qeverisë më 10 maj 2021.

7. Më 14 korrik 2021, Gjykata e Lartë e rrëzoi si të papranueshëm rekursin depozituar nga kompania kërkuese pranë Gjykatës së Lartë.

8. Më 28 shkurt 2022, kompania kërkuese paraqiti parashtrimet e saj përfundimtare pranë Gjykatës, duke përfshirë pretendimet për dëmshpërblim të drejtë.

B. Kuadri ligjor përkatës dhe informacioni për Gjykatën e Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese

9. Neni 31 § 2 i ligjit për gjyqësorin (ligji nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor") parashikon se, si rregull, trupi gjykues për proceset civile në Gjykatën e Lartë i shqyrton rekurset në trupa gjyqësore të përbërë nga tre gjyqtarë.

10. Sipas nenit 399/6 të Kodit të Procedurës Civile ("KPC"), në rastin kur një çështje është pezull pranë një trupe gjyqësore në Gjykatën e Lartë, ankesat në lidhje me kohëzgjatjen e procesit do të duhet të dëgjohen nga një trupë tjetër gjyqësore në Gjykatën e Lartë (shih *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, nr. 43391/18 dhe 17766/19, § 37, 12 tetor 2021).

11. Pas një sërë shkarkimesh dhe dorëheqjesh të gjyqtarëve nga detyra, nga data 22 maj 2019 deri më 18 mars 2020, Gjykatës së Lartë i mungonte kuorumi statutor prej tre gjyqtarësh për shqyrtimin e padive pranë saj. Gjykata e Lartë e rifitoi kuorumin minimal të gjyqtarëve më 18 maj 2020, dhe gjatë muajve në vijim u emëruan gjyqtarë të tjerë.

12. Për sa i përket Gjykatës Kushtetuese, sipas të dhënave zyrtare, nga data 16 korrik 2018 deri më 14 nëntor 2019, gjykatës i mungonte kuorumi statutor i gjyqtarëve prej tre gjyqtarësh për të shqyrtuar apelimet pranë saj. Ajo e rifitoi kuorumin minimal të gjyqtarëve më 14 nëntor 2019, dhe gjatë muajve në vijim u emëruan gjyqtarë të tjerë.

VLERËSIMI I GJYKATËS

A. Pretendim për shkelje të nenit 6 të Konventës

13. Kompania kërkuese u ankua në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës për refuzimin nga ana e gjykatave vendase për ta përjashtuar nga tarifa gjyqësore, dhe vlerësonte se meritat e padisë së saj paraqisnin një shkelje të të drejtave të saj për t'iu drejtuar gjykatës. Sipas së njëjtit parashtrim, kompania kërkuese u ankua për një kohëzgjatje të tepruar të procesit. Në vijim, në mbështetje të nenit 13 të Konventës, kompania kërkuese u ankua se nuk kishte asnjë mjet vendas efektiv për ankesat e saj.

14. Qeveria parashtroi se kompania kërkuese nuk kishte shteruar mjetet vendase. Kompania kërkuese e kundërshtoi pretendimin, duke argumentuar se në periudhën kur kompania kërkuese kishte depozituar kërkesën e saj pranë Gjykatës, nuk ekzistonin mjetet vendase efikase për t'u shteruar.

15. Parimet e përgjithshme në lidhje me shterimin e mjeteve vendase dhe parimi i subsidiaritetit janë përmbledhur në vendimin *Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë* ((kundërshtimi paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §§ 69-77, 25 mars 2014). Veçanërisht për sa i përket Shqipërisë, pas ndryshimeve të datës 12 gusht 2016

në lidhje me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, në parim, një rekurs kushtetues bëhej mjeti efektiv për t'u shteruar për të gjitha ankesat e bëra në mbështetje të Konventës (shih *Fullani kundër Shqipërisë*, (vendim) nr. 4586/18, § 79, 20 shtator 2022). Gjithashtu, në lidhje me ankesat për kohëzgjatjen e procesit, mjeti i ri që hyri në fuqi më 5 nëntor 2017, në parim duhet të shterohet përpara depozitimit të një ankese pranë Gjykatës (shih *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë,* nr. 43391/18 dhe 17766/19*,* § 119, 12 tetor 2021).

1. E drejta për t'iu drejtuar gjykatës

16. Gjykata thekson se më 18 tetor 2019, kur kompania kërkuese depozitoi kërkesën konkrete pranë Gjykatës, Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese në të vërtetë nuk mund të merrnin një vendim të menjëhershëm për ankesën e saj në lidhje me të drejtën e saj për t'iu drejtuar gjykatës, ankesë e cila tashmë është përpara Gjykatës. Megjithatë, nuk diskutohet që kjo ishte një situatë e përkohshme që autoritetet vendase po përpiqeshin ta adresonin, dhe që gjykatat më të larta po pranonin rekurse të depozituar pranë tyre në mënyrën tradicionale. Gjithashtu, palët nuk trajtojnë midis tyre se më 14 korrik 2021, datë kur Gjykata e Lartë shpalli vendimin për rekursin e kompanisë kërkuese në Gjykatën e Lartë (shih paragrafin 7 më sipër), Gjykata Kushtetuese ishte operative. Në të vërtetë, në atë periudhë, Gjykata Kushtetuese kishte qenë operative për më shumë se 21 muaj, që prej datës 14 nëntor 2019, datë në të cilën kishte rifituar kuorumin e nevojshëm për të gjykuar për disa prej rekurseve depozituar pranë saj (shih paragrafin 12). Edhe pse mundësia praktike e dëgjimit të rekursit kushtetues u mundësua vetëm pas datës së depozitimit të kërkesës së saj, kompanisë kërkuese iu kërkua sidoqoftë që ta shteronte atë mjet për të drejtën e saj për ta drejtuar ankesën në gjykatë.

17. Në parashtrimet e saj të fundit, më 28 shkurt 2022 pranë Gjykatës, kompania kërkuese nuk bëri të qartë nëse kishte paraqitur një ankesë kushtetuese ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë. Nëse ajo e ka depozituar një rekurs të tillë kushtetues, nuk ka ende asnjë indicie se Gjykata Kushtetuese ka nisur gjykimin për të. Për këtë arsye, kjo ankesë pranë Gjykatës në çdo rast është e parakohshme (shih në të njëjtin koncept, *Gjinarari kundër Shqipërisë* (vendim) [Komisioni], nr. 52610/19, §§ 14 dhe 20, 22 nëntor 2022). I takon kompanisë kërkuese që të ridepozitojë ankesën pranë Gjykatës pas shterimit të mjeteve vendase.

2. Kohëzgjatja e procesit

18. Në lidhje me pretendimin për shkelje të kërkesës për "afat të arsyeshëm", sipas nenit 6 § 1 të Konventës, që prej datës 5 nëntor 2017, sistemi ligjor shqiptar ka parashikuar një mjet të posaçëm në lidhje me këtë ankesë, i cili ka të bëjë me masën kompensuese dhe/ose përshpejtuese sipas nenit 399/1 e në vijim të KPC (shih *Bara dhe Kola*, cituar më sipër, §§ 37 dhe 119).

19. Në periudhën midis datës 5 nëntor 2017 dhe 22 maj 2019, periudhë në të cilën Gjykata e Lartë humbi përkohësisht kuorumin e nevojshëm për të gjykuar çfarëdo kërkese (shih paragrafët 10 dhe 11 më sipër), çështja e kompanisë kërkuese ishte ende pezull pranë Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, i takonte kompanisë kërkuese të depozitonte një padi dhe të merrte vendimin e Gjykatës së Lartë sipas nenit 399/1 e në vijim të KPC. Në të vërtetë, gjykata mori dhe gjykoi çështje të tjera të ngjashme gjatë asaj periudhe (shih *Bara dhe Kola*, cituar më sipër, §§ 39-43). Megjithatë, kompania

kërkuese nuk e përdori atë mundësi për të paraqitur ankesën e saj për kohëzgjatjen e procesit pranë Gjykatës së Lartë.

20. Nga data 22 maj 2019 deri më 18 mars 2020, Gjykatës së Lartë i mungonte kuorumi për shqyrtimin e një padie të mundshme, sipas nenit 399/1 e në vijim të KPC, gjë e cila, është e kuptueshme, që mund të ketë shkaktuar ngurrim për kompaninë kërkuese që ta paraqiste atë kërkesë pranë gjykatës. Megjithatë, theksohet përsëri se pranë Gjykatës nuk u ngrit çështja se mungesa e kuorumit ishte një situatë e përkohshme dhe për këtë arsye çdo kërkesë depozituar pranë gjykatës gjatë asaj periudhe do të shqyrtohej sapo Gjykata e Lartë të rifitonte kuorumin e nevojshëm. Në të vërtetë, Gjykata e Lartë rifitoi kuorumin e nevojshëm më 18 mars 2020 (shih paragrafin 11 më sipër), datë në të cilën pranë saj nuk kishte asnjë kërkesë pezull paraqitur nga kompania kërkuese sipas nenit 399/1 e në vijim të KPC-së.

21. Së fundmi, nuk kishte asnjë arsye që e pengonte kompaninë kërkuese të paraqiste një kërkesë të tillë pranë gjykatës në periudhën nga data 18 mars 2020 dhe 24 korrik 2021, datë në të cilën Gjykata e Lartë e rrëzoi rekursin depozituar pranë saj në lidhje me meritat e mosmarrëveshjes (shih paragrafin 7 më sipër dhe *Bara dhe Kola,* cituar më sipër, § 15, ku tregohet se gjatë asaj periudhe Gjykata e Lartë gjykonte kërkesat e depozituara nga palë të tjera sipas nenit 399/1 e në vijim të KPC).

22. Në një vlerësim të përgjithshëm për rrethanat specifike të çështjes konkrete dhe pavarësisht çdo ngurrimi të krijuar nga mungesa e gjyqtarëve të mjaftueshëm në Gjykatën e Lartë për një periudhë të caktuar, Gjykata është e mendimin se kompanisë kërkuese, sidoqoftë, i është kërkuar që t'i jepte gjykatës mundësinë që të gjykonte ankesën e saj për pretendimin për kohëzgjatje të procesit sipas nenit 399/1 e në vijim të KPC. Pasi një gjë e tillë nuk u përmbush, ankesa është e papranueshme për mosshfrytëzim të mjeteve vendase sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

B. E drejta për një mjet efektiv

23. Kompania kërkuese e kishte pasur mundësinë për të paraqitur ankesat e saj pranë autoriteteve vendase (shih paragrafët 17 dhe 22 më sipër). Ankesa e saj në mbështetje të nenit 13, së bashku me nenin 6 të Konventës, se nuk kishte mjete efektive për të adresuar ankesat e saj, për këtë arsye është e pambështetur në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

E deklaron kërkesën të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar më shkrim më 22 qershor 2023.

ZËVENDËSREGJISTRARE **Olga Chernishova**

KRYETAR **Georgios A. Serghides**